



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 821 Prot.

Tiranë, më datë 17.08.2020

VENDIM

Nr. 276, datë 17.08.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 17.08.2020,

VENDOSI:

1. Shtyrjen e vendimmarrjes për projektin “Tabelat informuese në Parkun Arkeologjik të Bylisit”, hartuar nga specialistët e IKTK-së, IA-së dhe të ZAK Apolloni;
- Të hiqet vendosja e citimeve të bibliografisë në tabela;
2. Të ngrihet një grup pune me 4 ekspertë, me përfaqësues nga Ministria e Kulturës, Instituti i Arkeologjisë, Universiteti i Tiranës dhe IKTK të cilët do të realizojnë redaktimin/rishikimin e tekstit dhe formatimin e tabelës;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

KRYETAR

Elva MARGARITI

